





01-323

	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-53617/22 dt. 10.03.2022, të pronarëve Rrahman Hoti dhe Osman Huseni nga Prishtina, dhe investitorit N.N.T. “Ndërtimi A”, me seli në Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin e ndërtesave shumë banesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “C13”, të tërësisë “C” të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 05.07.2022, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Rrahim Hoti dhe Osman Huseni nga Prishtina me investitorit N.N.T. “Ndërtimi A”, seli në Gjilan, me certifikatë të regjistrimit ARBK 811209750, me përfaqësues Ramiz Thaqi, me sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-53617/22 dt. 10.03.2022, përdorimi i kompleksit të ndërtesave shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesës “A” dhe “B” me etazhitet 2B+P+6ET të ndërtuara sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-283508 dt. 06.10.2015, në kuadër të bllokut urbanistik “C13”, të tërësisë “C” të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë në rrugën “Uran Ajeti” dhe rrugën “Teodor Muzaka” konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1546-2, ZK Matičan.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugët “Uran Ajeti” dhe rrugën “Teodor Muzaka” ku kanë dalje hyrjet e këtyre ndërtesave me numrat: 7, 9, 11, 13, 15, 17, 84, 88, 90, 92, 94, 96 dhe 98 në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të saja në evidencat e regjistrimit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarët Rrahim Hoti dhe Osman Huseni nga Prishtina nga Prishtina dhe investitori N.N.T. “Ndërtimi A”, me seli në Gjilan, me certifikatë të regjistrimit ARBK 811209750, me përfaqësues Ramiz Thaqi, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-53617/22 dt. 10.03.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e

certifikatës së përdorimit për kompleksin e ndërtesave shumë banesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesës “A” dhe “B”, me etazhitet 2B+P+6ET, të ndërtuara në kuadër të urbanistik “C13”, të tërësisë “C” të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1546-2, ZK Matiqan, të ndërtuara sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore Ndërtimore 05 Nr. 351-283508 dt. 06.10.2015, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-50977/21 dt. 16.12.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimin mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Naser Surdulli; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Yllka Beka; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjetillësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Naim Munishi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Berat Hasanaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Gazmend Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Nazmi Bajrami, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar Burim Halilaj me nr. të licencës 195;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjetillësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumë banesore me afarizëm.



Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-53617/22 DT. 05.07.2022**

Zyrtari,
Berim Osmanaj

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi

Drejtori,
Arber Sadiki



